



Pranuar / Dorezuar Priljena / Predato Received / Delivery	07 - 09 2022	viti god year	
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKINSHICK	5212/2022		1/4



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.653/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.653/2022 të datës 25.07.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë: rruga

Komunë të Prishtinës, kundër organit të punësimit Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës, në çështjen juridike “masë disiplinore-vërejtje me shkrim”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 07.09.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET si e bazuar ankesa më numër A.nr.653/2022 e datës 25.07.2022 e parashtruar nga ankuesi

II. ANULOHET masa disiplinore „Vërejtje me shkrim” me numër protokolli 4523 e datës 28.06.2022, e shqiptuar nga Drejtorja e Drejtorisë së Inspektoratit në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinës.

III. OBLIGOHET Kryeshefi Ekzekutiv dhe Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinës, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të bëjë zbatimin e këtij vendimi duke bërë shuarjen e masës disiplinore nga dosja personale e ankuesit në pajtim me këtë vendim.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m





Ndaj ankuesit i punësuar në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinës sipas Akt emërimit të datës 31.03.2013, në pozitën „Udhëheqës i Sektorit të Inspektoratit Sanitar“, në Drejtorinë e Inspektoratit, me datë 28.06.2022, Drejtorja e Drejtorisë së Inspektoratit në Agjencinë e

Ushqimit dhe Veterinës në cilësi të mbikëqyrëses së drejtpërdrejtë i ka shqiptuar masën disiplinore „Vërejtje me shkrim“, me arsyetimin për mos përmbushje të obligimit zyrtar gjegjësisht për mospjesëmarrje në grupin punues sipas Vendimit të Zëvendësuesit të Kryeshëfit Ekzekutiv me nr.3855 të datës 31.05.2022 për draftimin e Rregullores për Kontrollin Zyrtar.

Me datë 25.07.2022, ankuesi ka parashtruar ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër „Vërejtjes me shkrim“ të datës 28.06.2022 me numër protokoll 4523 me pretendime se mbikëqyrësja e tij e drejtpërdrejtë, me rastin e shqiptimit të vërejtjes me shkrim, nuk e ka konstatuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike sepse vërejtja me shkrim është nxjerrë në kundërshtim me ligjin, dhe se nuk janë marrë parasysh angazhimet e tija, të cilat kanë qenë si prioritete nga udhëheqësit për pjesëmarrje aktive, duke filluar nga çështjet sipas ftesave apo kërkesave nga Parlamenti, Qeveria, komunikimi permanent me mediat e shkruar dhe elektronike të gjitha këto të dëshmuara me prova-dëshmi ftesa, kërkesa, vendime për caktime në grupe punuese dhe shkresa elektronike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 26.07.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës. Më datë 19.07.2022 Njësia e personelit në Shërbimin Korrektues të Kosovës, ka dërguar përgjigjen në ankesë me provat e bashkangjitura.

**Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën e regjistruar me datë 25.07.2022 e parashtruar nga ankuesi me numër protokoll 4275/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vërejtje me shkrim e datës 28.06.2022 me numër protokoll 4523-1; Vendim nr.3855 i datë 31.05.2022; Vendimi nr.05-465 i datë 01.02.2022; E-mail i datës 31.05.2022; Vendim nr.05-486 i datë 02.02.2022; Vendim nr.053500 i datë 15.07.2022; E-mail i datës 04.07.2022; Ftesë E-mail i datës 01.07.2022; Mbledhja e komisionit e datës 01.07.2022 ; Ftesë për takim /E-mail i datës 01.06.2022 Divizioni Farmacisë; Vendim nr.05-2679 i datë 06.06.2022; E-mail i datës 06.06.2022; shkresë zyrtare -Indikatorët e përformancës së programit buxhetor -AUV-2023/2024, prej 1/3 faqe; E-mail i datës 27.05.2022 për informim dhe i datës 26.05.2022; E-mail i datës 20.05.2022; E-mail i datës 19.05.2022; E-mail i datës 18.05.2022 dhe datës 17.05.2022; E-mail i datës 04.05.2022; E-mail i datës 28.04.2022; E-mail i datës 27.04.2022; E-mail i datës 26.04.2022; E-mail i datës 24.04.2022; E-mail i datës 22.04.2022; E-mail i datës 21.04.2022; Kërkesë për kontroll i datës 19.04.2022; E-mail i datës 06.04.2022; E-mail i datës 06.06.2022-rendi i ditës për ora 10 me datë 09.06.2022; E-mail i datës 15.06.2022; E-mail i datës 08.07.2022; Vendim nr.1127 i datë 09.02.2022; Vendim nr.3326 i datë 29.04.2021; Vendim nr.497 i datë 25.01.2021; Vendim nr.9288 i datë 06.12.2018; Përgjigje në ankesë e datës 05.08.2022 nr. protokoll 4568/2022; Akt emërimi i datës 31.01.2013; Përshkrim i detyrave të Punës i datës 01.06.2011; E-mail i datës 03.08.2022; E-mail i datës 01.06.2022; E-mail i datës 31.05.2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura në lëndë, të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e bazuar, sepse:



Ankuesi në ankesën e parashtritur në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër masës disiplinore "Vërejtje me shkrim" me numër protokolli 4523, të datës 28.06.2022 pretendon se mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i tij, me rastin e shqiptimit të vërejtjes me

shkrim, nuk e ka konstatuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike sepse vërejtja me shkrim është nxjerrë në kundërshtim me ligjin, dhe se nuk janë marrë parasysh angazhimet e tija, të cilat kanë qenë si prioritete nga udhëheqësi për pjesëmarrje aktive, duke filluar nga ftesat dhe kërkesat për çështjet e caktuara të arritur nga Parlamenti, Qeveria, komunikimi permanent me mediat e shkruar dhe elektronike.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke ju referuar Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, gjegjësisht nenit 46 ku janë paraparë shkeljet disiplinor si: Shkelje të rënda dhe shkelje të lehta, ndërsa sipas nenit 46 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, *Shkelje të lehta konsiderohen: 4.1. mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune; 4.2. shkelja e rregullave të etikës; 4.3. sjellja e parregullt, gjatë kohës së punës, me mbikëqyrësit, kolegët, vartësit dhe me publikun; 4.4. kryerja e veprimeve, që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi, brenda ose jashtë orarit zyrtar*, rrjedhimisht, sipas Kolegjit mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankuesit me rastin e shqiptimit të masës disiplinore ndaj ankuesit nuk ka vlerësuar se cilën nga këto shkelje i ka kryer ankuesi, e që sipas këtij ligji është obligim i mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë që fillimisht të vlerësoj se çfarë shkelje ka bërë ankuesi në mënyrë që të shqiptohet masa disiplinore, respektivisht nuk ka specifikuar se në cilën datë ankuesi nuk ka marr pjesë në takim. Po ashtu mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankuesit nuk ka marr parasysh faktin që ankuesi përveç detyrave dhe përgjegjësi sipas [përshkrimit të vendit të punës ka qene i angazhuar edhe me punë tjera gjegjësisht i caktuar në të njëjtën kohe edhe në shumë grupe tjera punese konkretisht sipas Vendimit me Nr. 52/II/2022 të datës 01.02.2022 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë është caktuar anëtar i ekipit mbështetës për hartimin dhe finalizimin e Udhëzimit Administrativ për Vërejtje e Kombinuara në Njësinë e Paketimit, sipas Vendimit me Nr. 54/II/2022 të datës 02.02.2022 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë është caktuar anëtar i ekipit mbështetës për hartimin dhe finalizimin e Projektligjit për Parandalimin dhe Kontrollimin e Sëmundjeve Ngjithëse, sipas Vendimit me Nr. 278/VII/2022 të datës 16.07.2022 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë është caktuar anëtar i ekipit mbështetës për hartimin dhe finalizimin e Projektligjit për Inspektive Shëndetësore, sipas Vendimit me Nr. 223/VI/2022 të datës 06.06.2022 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë është caktuar anëtar i grupit punues për përditësimin e Strategjisë Shtetërore për Parandalim, Menaxhim dhe Trajtim të COVID-19, kështu që masa disiplinore "Vërejtje me shkrim" e datës 28.06.2022 me numër protokolli 4523 e shqiptuar ndaj ankuesit është bërë vetëm me një përshkrim pa konstatuar datat kur ankuesi nuk ka marr pjesë në takim si dhe nuk ka bërë përpjekje për të përfillur detyrat shtese dhe angazhimet e tjera të cilat sipas dëshmimeve të ofruara kanë qene pothuajse në të njëjtën kohe, andaj Kolegji konstatoi se mbikëqyrësja e drejtpërdrejtë me rastin e shqiptimit të masës disiplinore "Vërejtje me shkrim" ndaj ankuesit nuk ka arritur të konstatoj drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike, që në fakt si e tillë „vërejtja“ nuk përmban bazë ligjore e as arsyetim pse është e zbatueshme.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankuesit me rastin e shqiptimit të masës disiplinore nuk ka arritur të konstatoj në mënyrë të saktë se cili është dëmi dhe pasoja e shkaktuar nga veprimi i ankuesit, rrjedhimisht sipas Kolegjit, nuk janë plotësuar kushtet për ekzistimin e elementeve disiplinore të përcaktuara me nenin 45 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: "*Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi*



apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit", elemente këto që duhet plotësuar kumulativisht në mënyrë që të ekzistoj përgjegjësi disiplinore, e në rastin konkret të ankueses, mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i ankuesit me rastin e shqiptimit të masës disiplinore nuk ka arritur të bëjë vlerësimin e tyre, duke mos marr për bazë dispozitat e nenit 50 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe nenit 13 paragrafi 4 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në të lartcekurat, konstaton se masa disiplinore e shqiptuar ndaj ankuesit, është në kundërshtim me legjislacionin për zyrtarët publikë, respektivisht në kundërshtim me nenin 45, 46 paragrafi 4, nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, nenin 48 paragrafi 1 dhe 2, nenin 50 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe dispozitave të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë.

Si u tha më lartë, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se obligohet Kryeshefi Ekzekutiv dhe Udhëheqësi i Njësisë së Burimeve Njerëzore i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, që në pajtim me dispozitivin e këtij vendimi të bëjnë shuarjen e masës disiplinore ndaj ankuesit në pajtim me këtë vendim.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të inicioj konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.Nr.652/2022.

Zyle Millaku GOJNOVCI

Procesmbajtëse

MALSORE GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit,
- Kryeshefit Ekzekutiv në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinës
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

